

# ANALIZË E (PA)BARAZIVE GJINORE

NËPËRMJET PRIZMIT TË RINJVE NË MAQEDONINË E VERIUT



Analizë gjinore e perceptimeve për stereotipet gjinore, paragjykimet dhe pabarazitë e të rinjve në Maqedoninë e Veriut



British Embassy  
Skopje



**UKaid**  
from the British people



Këshilli Rinor Nacional  
i Maqedonisë



Stella

# REZYME

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka mungesë të hulumtimit mbi qëndrimet e të rinjve ndaj barazisë gjinore. Ky studim fokusohet në ndjeshmërinë gjinore të të rinjve, përkatësisht stereotipet dhe paragjykimet gjinore që kanë të rinjtë dhe ndikimi i tyre në forcimin e pabarazive gjinore në shoqëri.

Studimi përpiqet të vlerësojë shkallën e njohjes së pabarazive gjinore në jetën e përditshme nga të rinjtë, si dhe të kuptojë qëndrimet, perceptimet dhe mendimet e tyre për pozicionin e grave, burrave dhe identiteteve gjinore jo binare në Republikën e Maqedonisë së Veriut

**BOTUES:**

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë

Rr. Veljko Vlahovi nr. 7 / 1-1, 1000 Shkup

www.nms.org.mk

info@nms.org.mk

Shoqata për mundësi të barabarta Rrjeti Stella Shkup

Rr. Arhiepiskop Dositej nr. 39-16 Çair, Shkup

www.stella.mk

info@stella.mk

**RRETH BOTUESIT:**

Filip Ivkovski, Aktrimi President

Natasha Dimova, President

**REDAKTORE:**

Mariana Angelova

**AUTORE:**

Ljupka Trajanovska

**EKIPI KËRKIMOR:**

Natasha Pavikjevikj- Stojmenovska

Nikolina Nikolovska

**BASHKËPUNESËT:**

Mariana Angelova, Aleksandra Filipova, Sara Milenkovska

**TITULLI I ORIGJINALIT:**

АНАЛИЗА НА РОДОВИТЕ (НЕ)ЕДНАКВОСТИ НИЗ ПРИЗМАТА НА МЛАДИТЕ  
ВО СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

**LEKTOROI:**

Valentina Joshevska

**PËRKTHIM NGA GJUHA MAQEDONASE:**

Vjosa Taipi

**DIZAJN:**

Ilija Stankvoski

**VITI I BOTIMIT:**

2023, Shkup

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>1</b>
<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>POLITIKAT RINORE DHE BARAZIA GJINORE NË RMV</b>	<b>8</b>
<b>KUADRI KONCEPTUAL</b>	<b>12</b>
<b>METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT</b>	<b>16</b>
<b>OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT</b>	<b>16</b>
<b>METODOLOGJIA E HULUMTIMIT</b>	<b>16</b>
<b>PARIMET ETIKE NË HULUMTIMIN DHE ANALIZËN E REALIZUAR</b>	<b>19</b>
<b>GJETJET KRYESORE</b>	<b>20</b>
<b>ANALIZA GJINORE E PERCEPTIMEVE TË STEREOTIPEVE GJINORE, PARAGJYKIMEVE DHE PABARAZIVE TË RINJVE NË MAQEDONINË E VERIUT</b>	<b>22</b>

# PËRMBAJTJA

<i>SA ËSHTË VETËDIJA E TË RINJVE PËR (PA)BARAZINË GJINORE?</i>	<b>23</b>
<i>STEREOTIPET GJINORE: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PËRVOJAT E TË RINJVE</i>	<b>26</b>
<i>A PRAKTIKOJNË TË RINJTË MENDIMIN GJINOR (JO)STEREOTIPIK?</i>	<b>32</b>
<i>SJELLJA, EMOCIONET, AFTËSITË DHE PAMJA</i>	<b>32</b>
<i>ZGJEDHJA E ARSIMIT</i>	<b>36</b>
<i>TREGU I PUNËS</i>	<b>40</b>
<i>AKTIVITETI POLITIK DHE PJESËMARRJA NË VENDIMMARRJE</i>	<b>45</b>
<i>KUJDESI PËR SHTËPINË DHE FAMILJEN</i>	<b>48</b>
<i>SI TË PËRMIRËSOHET STATUSI I VAJZAVE/GRAVE NË SHOQËRI?</i>	<b>52</b>
<b>PËRFUNDIMEDHE REKOMANDIME</b>	<b>54</b>

# HYRJE

Barazia gjinore është prioritet kyç dhe angazhim i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me aderimin në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në vitin 1991 dhe nënshkrimin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformën për Veprim në vitin 1995, shteti u angazhua të përmirësojë statusin e grave të kontribuojë në fuqizimin e tyre në jetën publike dhe private. Përveç kësaj, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Maqedonia e Veriut është angazhuar për arritjen e barazisë gjinore de jure dhe de facto dhe për të siguruar zhvillimin dhe promovimin e plotë të të drejtave të grave.

Si një nga dokumentet më të rëndësishme strategjike në fushën e barazisë gjinore, Ligji për mundësi të barabarta të burrave dhe grave u miratua për herë të parë në vitin 2006, me ndryshime në vitin 2012 dhe 2014. Objektivi kryesor i Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave është të krijojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha sferat e veprimit shoqëror (politik, ekonomik, social, arsimor, kulturor, shëndetësor, qytetar) dhe përmban përkufizimet themelore të përfaqësimit dhe përfshirjes së barabartë në rrjedhat kryesore të jetës shoqërore. Këtu ndërlihen Strategjia për barazi gjinore 2013 – 2020, si dhe Strategjia për barazi gjinore 2022 – 2027<sup>1</sup> (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së V. nr. 170/22).

Strategjia aktuale për barazi gjinore është një dokument themelor strategjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut që krijon një kornizë gjithëpërfshirëse me aktivitete për promovimin e barazisë gjinore. Strategjia thekson pabarazitë në tregun e punës, hendekun gjinor si dhe punën e papaguar të grave dhe vajzave, rëndësinë e përfshirjes së grave dhe vajzave në mbrojtjen e mjedisit dhe trajtimin e ndryshimeve klimatike, por gjithashtu thekson nevojën për përfshirje më aktive të grave në politikë dhe në pozita vendimmarrëse. Seksizmi dhe sjellja seksiste janë identifikuar si shkaqet e drejtpërdrejta të dhunës ndaj grave dhe vajzave, ndërsa stereotipet dhe paragjykimet gjinore formojnë normat, sjelljet dhe pritjet e burrave dhe djemve që rezultojnë në akte seksiste. Të rinjtë në Strategji janë në shënjestër të drejtpërdrejtë në fushën e arsimit, me veprime të parashikuara për përfshirjen e vajzave nga grupet e cenueshme dhe inkurajimin e vajzave të reja për të zgjedhur profesione më të paguara, në të cilat burrat janë statistikisht më të përfaqësuar. Për më tepër, Strategjia parashikon krijimin e plotë të programit për SHMP në të gjitha shkollat, i cili parashikon një ulje afatgjatë të pabarazive gjinore në shoqëri.

Një dokument që duhet të kontribuojë ndjeshëm në promovimin e barazisë gjinore është propozim-Ligji për barazinë gjinore, i cili synon të sigurojë realizimin e barazisë së plotë gjinore në të gjitha sferat e jetës publike dhe private

1. Strategjia për barazi gjinore 2022-2027, në dispozicion online në [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategija\\_%D0%A1%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0\\_%D0%B7%D0%B0\\_%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0\\_%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82\\_2022\\_2027.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategija_%D0%A1%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0_%D0%B7%D0%B0_%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0_%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82_2022_2027.pdf)

duke forcuar pozitën dhe statusin e grave në shoqëri dhe duke ofruar mundësi të barabarta për realizimin e të gjitha të drejtave përmes promovimit të barazisë gjinore; veçanërisht në aspektin e çrrënjosjes së stereotipeve dhe paragjykitimeve gjinore - krijimi dhe zbatimi i masave dhe mjeteve/ aktiviteteve për barazinë gjinore udhëhiqen nga parimi i çrrënjosjes së stereotipeve dhe paragjykitimeve gjinore që bazohen në idenë e inferioritetit të grave dhe roleve stereotipike të grave dhe burrave.

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi i<sup>2</sup> miratuar në fund të vitit 2020 rregullon format dhe llojet e diskriminimit, si dhe procedurat për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përcakton parimin e barazisë si parim sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, përkatësisht të barabartë në gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive. Neni 5 i këtij ligji përcakton: "ndalohet çdo diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, origjinës, kombësisë ose etnisë, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë së një grupi të marginalizuar, gjuha, shtetësia, origjina sociale, arsimimi, feja ose bindja fetare, bindja politike, aftësia e kufizuar, mosha, statusi martesor ose familjar, gjendja pronësore, gjendja shëndetësore, statusi personal dhe statusi shoqëror ose çdo bazë tjetër."

Përveç kësaj, në prill 2022, u miratua Strategjia Kombëtare për Barazi dhe mos diskriminim 2022-2026<sup>3</sup>, e cila bazohet në parimin e kryqëzimit, përkatësisht mbulon të gjitha aspektet e ndryshme të identitetit njerëzor që janë të ndërlydhura dhe të ndërthurura në nivele dhe dimensione të ndryshme. Diskriminimi i shumëfishtë dhe ndër-sektorial në vendin tonë trajtohet përmes punës së Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Jo më pak i rëndësishëm është miratimi i Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna mbi gratë dhe dhuna në familje<sup>4</sup> nga viti 2021, i cili përcakton që masat, aktivitetet dhe shërbimet për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, duhet të jenë përgjegjëse gjinore dhe të njohin karakteristikat dhe dallimet që rrjedhin nga rolet gjinore të grave dhe burrave, në mënyrë që rezultatet e masave, aktiviteteve dhe shërbimeve të kontribuojnë në barazinë gjinore (neni. 9).

Në vitin 2019, Këshilli i Evropës në Rekomandimin e tij për parandalim dhe luftë kundër seksizmit vuri në<sup>5</sup> dukje se seksizmi, si një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, pengon fuqizimin e grave dhe vajzave, ndërsa stereotipet dhe paragjykimet gjinore for-

2. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, i disponueshëm online në <https://www.mtsp.gov.mk/content/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%B-D%20%D0%B7%D0%B0%D0%20%D1%81%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%20%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0%20%D0%BE%D0%B4%20%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf>

3. Strategjia Kombëtare për Barazi dhe Mosdiskriminim 2022-2026, e disponueshme online në [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategj-ja/\\_%D0%9D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B0%20%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20%D0%B8%20%D0%BD%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%20%202022-2026.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategj-ja/_%D0%9D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B0%20%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20%D0%B8%20%D0%BD%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%20%20%202022-2026.pdf)

4. Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, në dispozicion online në <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/1a28a922f364401e94935d4d694b9d75.pdf>

5. Rekomandimi CM / Rec (2019), i disponueshëm online në <https://rm.coe.int/prems-055519-gbr-2573-cm-rec-2019-1-web-a5-v2-mk/168096a30a>

formojnë normat e sjelljes së djemve dhe burrave, duke çuar në sjellje diskriminuese dhe akte seksiste. Përveç kësaj, prevalenca e manifestimeve të ndryshme të seksizmit është e lidhur ngushtë me vështirësitë e vazhdueshme në arritjen e barazisë gjinore. Konventa e Stambollit, e cila është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2018, u bën thirrje shteteve anëtare "të promovojnë ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave në mënyrë që të zhdukin paragjykimet, zakonet, traditat dhe të gjitha praktikrat e tjera të bazuara në idenë e inferioritetit të grave ose rolet stereotipike të grave dhe burrave".

Hulumtimet dhe analizat e shumta<sup>6</sup> kanë treguar se sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i mbushur me tekste shkollore përplot me stereotipe dhe diskriminim kryesisht për gratë, por edhe për të gjithë personat që nuk jetojnë sipas normave dhe roleve gjinore. Duke pasur parasysh se tekstet shkollore pasqyrojnë normat dhe vlerat e një shoqërie, ato gjithashtu mund të jenë një mjet politik me përmbajtje të seleksionuara, përzgjedhura ose të shtrembëruara. Prandaj, prania e stereotipeve gjinore në tekstet shkollore mund të jetë bazë për praktikrat diskriminuese dhe ruajtjen e pozitës së pabarabartë të grave në shoqëri<sup>7</sup>.

Shteti, pavarësisht përpjekjeve shumëvjeçare, ende nuk ka edukim seksual formal në shkollat fillore dhe të mesme. Disa nga përfitimet kryesore të futjes së SHMP në shkolla janë pikërisht zhvillimi i ndërgjegjësimit për pasojat e dëmshme individuale dhe sociale të diskriminimit në bazë të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, ndërsa me këtë edhe forcimin e barazisë gjinore. Gjatë vitit 2020/21, u hartua dhe u përshtat me moshën program mësimor, të cilën BZHA e miratoi si një program fillestar për realizimin e një pilot- mësimi me nxënës të klasës së 9-të në vitin shkollor 2021/22. Në vitin 2021, në baza vullnetare, u zhvilluan disa ditë trajnime për mësimdhënësit të cilët gjithashtu morën pjesë në realizimin e programit pilot<sup>8</sup>. Është hartuar gjithashtu një draft i Strategjisë Kombëtare për SHMP për periudhën 2023-2028 i cili ende nuk është miratuar.

---

6. S. Simonovska (2022) Analiza gjinore e teksteve shkollore - Shoqëria për klasën V dhe Art për klasën VII; I. Cvetković (2021), Analiza gjinore e teksteve shkollore në arsimin fillor; B. Kotevska, (2016) Stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimi në arsim: Fokusi në tekstet shkollore të arsimit fillor "; D. Drndarevska (2010) Analiza e përfaqësimit gjinor, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit të tekstit shkollor "Etika në religjionet" për klasën V;

7. Simonovska, S. (2020) Analizë për praninë e stereotipeve gjinore në materialet mësimore në gjuhën maqedonase me rekomandime për vendimmarrësit. Shkup: Instituti për të Drejtat e Njeriut.

8. HERA (2023), Hulumtim mbi qëndrimet e mësuesve për vendosjen e AMP-së në arsimin fillor para dhe pas pilotimit të programit, në dispozicion online në <https://hera.org.mk/wp-content/uploads/2023/06/Istrazhuvanje-Stavovi-na-nastavnici-za-SSO-mk.pdf>




## POLITIKAT RINORE DHE BARAZIA GJINORE NË RMV

Të rinjtë kanë një rol të veçantë në shoqëri dhe përballen me sfida specifike. Adoleshenca është një periudhë vendimtare në të cilën normat gjinore konsolidohen dhe adoleshentët zhvillojnë qëndrime ndaj barazisë gjinore, por gjithashtu pranojnë role gjinore të bazuara në stereotipe gjinore, të cilat janë baza për zgjedhjet dhe vendimet e tyre të mëtejshme të jetës. Dallimet gjinore bëhen më të theksuara në adoleshencë.

Për shkak të normave të përhapura gjinore, vajzat adoleshente përballen me një barrë disproporcionale të punës së papaguar, pritjeve për martesë të hershme, rreziqeve të shtatzënisë së hershme dhe dhunës seksuale dhe me bazë gjinore. Normat gjinore gjithashtu ndikojnë negativisht tek adoleshentët. Kështu, normat rreth maskulinitetit që inkurajojnë marrjen e rrezikut, për shembull, shoqërohen me nivele më të larta të vdekshmërisë për shkak të lëndimeve në rrugë dhe vrasjeve midis adoleshentëve më të rritur<sup>9</sup>. Në të gjithë botën, gratë e reja vazhdojnë të përballen me diskriminim gjinor, marginalizim dhe dhunë, duke përfshirë qasjen e pabarabartë në arsim dhe mundësitë për udhëheqje dhe pjesëmarrje.

Në vitin 2018, me iniciativë të Klubit për çështje dhe politika rinore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, filloi procesi për krijimin e Ligjit për të rinjtë. Prosesi vazhdoi për herë të dytë, pasi në vitin 2011 nga shteti, me kërkesë të sektorit të rinisë, propozim - ligji i atëhershëm për të rinjtë u tërhoq.

Sipas Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, "të rinj" do të thotë persona të moshës 15 deri në 29 vjeç. Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2021 i<sup>10</sup> publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikave, popullsia e përgjithshme rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut është 1,836,713 qytetarë, nga të cilët 17.8% përbëhet nga popullata e re e moshës 15 deri në 29 vjeç, nga të cilët 167,284 burra të rinj dhe 159,449 gra të reja.



Grafiku 1. Popullsia e re sipas gjinisë

9. Gender equality, UNICEF, достапно онлајн на <https://data.unicef.org/adp/snapshots/gender-equality/>

10. Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, Regjistrimi i popullsisë 2021, në dispozicion online në [https://makstat.stat.gov.mk/PX-Web/pxweb/mk/MakStat/Mak-Stat\\_Popisi\\_Popis2021\\_NaselenieVkupno\\_Naselenie\\_VozrastiPol/T1018P21.px?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef](https://makstat.stat.gov.mk/PX-Web/pxweb/mk/MakStat/Mak-Stat_Popisi_Popis2021_NaselenieVkupno_Naselenie_VozrastiPol/T1018P21.px?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef)

Popullsia rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas grup moshave, sipas gjinisë, Regjistrimi 2021

Gjinia Grupet e moshës	Totali	Përqindja e popullsisë totale	Burra	Gra
15 - 19	104 035	5,6%	53 405	50 630
20 - 24	106 553	5,8%	54 525	52 028
25 - 29	116 145	6,3%	59 354	56 791


Tabela 1. Popullsia e re rezidente e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas gjinisë, sipas grup moshave, Regjistrimi 2021 (ESHs)

Numri më i madh i popullsisë së re i përket grup moshës 25-29 vjeç, pasuar nga 20-24 vjeç dhe më pak të rinj në Maqedoninë e Veriut janë nga grup moshë 15-19 vjeç, përkatësisht adoleshentë. Shumica e të rinjve jetojnë në rajonin e Shkupit, pasuar nga rajoni i Pollogut, ndërkaq gra të reja në secilin rajon ka më pak sesa burra të rinj. Rajoni i Vardarit ka numrin më të vogël të të rinjve në strukturën e popullsisë së tij.

Shpërndarja e të rinjve sipas grup moshave



Grafiku 2. Përfaqësimi i të rinjve sipas grup moshës



Grafiku 3. Popullsia totale rezidente e moshës 15-29 vjeç sipas gjinisë, sipas rajonit

Perspektiva gjinore është një aspekt i pandashëm i aktiviteteve dhe projekteve rinore, prandaj është hapi i parë për të identifikuar mënyrat në të cilat prezantohet dhe trajtohet përmbajtja gjinore, si në aktivitetet dhe politikat rinore, ashtu edhe në marrëdhëniet midis njerëzve të përfshirë në aktivitete dhe procese të politikëbërjes.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitet e fundit ka pasur përparim të dukshëm në përfshirjen e drejtpërdrejtë të të rinjve në krijimin e politikave për mbështetjen e të rinjve në të gjitha segmentet e shoqërisë: pjesëmarrja e të rinjve, zhvillimi politik, ekonomik dhe social, tregu i punës, vullnetarizmi, etj. Në nivel politikash, është arritur sukses i konsiderueshëm me miratimin e Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore<sup>11</sup> (LPRPR) në vitin 2020. Parimi i parë themelor i LPRPR është parimi i "barazisë, mundësive të barabarta dhe ndalimit të diskriminimit", megjithatë barazia gjinore dhe diskriminimi gjinor nuk përcaktohen me këtë ligj dhe nuk ka përfshirje të përshtatshme të dukshme të perspektivës gjinore në të.

Gjuha e përdorur në LPRPR është neutrale ndaj gjinisë, ndërsa në nenin 4 thuhet se "shprehjet e përdorura në këtë ligj që janë specifike për gjininë përdoren në mënyrë neutrale dhe i referohen në mënyrë të barabartë personave të gjinisë mashkullore dhe femërore".<sup>12</sup> Kjo na tregon se LPRPR nuk njeh dhe adreson nevojat specifike të djemve dhe vajzave, dhe nuk parashikon masa të veçanta që do të forconin barazinë gjinore midis të rinjve. Barazia gjinore nuk merr vëmendjen e duhur në Draftin e ri të Strategjisë Kombëtare për të rinjtë<sup>13</sup>, përkatësisht asnjë qëllim strategjik nuk ka fokus në forcimin e barazisë gjinore. Në krahasim, në Strategjinë Rinore të Bashkimit Evropian 2019-2027, barazia gjinore<sup>14</sup> është objektivi i dytë kryesor, përkatësisht vendet e Bashkimit Evropian përpiqen të sigurojnë "barazinë e të gjitha qasjeve gjinore dhe të ndjeshme gjinore në të gjitha fushat e jetës së një të riu".

Në nivel evropian, barazia gjinore midis të rinjve ka qenë një shqetësim i sektorit të të rinjve të Këshillit të Evropës që nga fillimi i tij. Kontribuesit më të mëdhenj janë organizatat rinore, të cilat vazhdimisht kontribuojnë në temën që do të përditësohet në programin e aktiviteteve të Qendrave Rinore Evropiane. Strategjia e Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore<sup>15</sup> 2018-2023 përmban këto gjashtë fusha strategjike:

- Parandalimi dhe luftimi i stereotipeve gjinore dhe seksizmit.
- Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- Sigurimi i qasjes së barabartë për gratë në drejtësi.
- Arritja e pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike.

11. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, Gazeta zyrtare e RMV, nr. 10/2020, në dispozicion online në <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/862649465cf4432aadcb4119f52bfd81.pdf>

12. Ibid. Neni 4

13. Draft Strategjia Kombëtare për të rinjtë e Maqedonisë së Veriut, në dispozicion online në <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detailid=48>

14. Strategjia Rinore e Bashkimit Evropian 2019-2027, në dispozicion online në [https://youth.europa.eu/structure\\_en](https://youth.europa.eu/structure_en)

15. Strategjia e Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore 2018-2023, në dispozicion online në <https://rm.coe.int/prems-093618-gbr-gender-equality-stroduction-2023-web-a5/16808b47e1>

- Mbrojtja e të drejtave të grave dhe vajzave emigrante, refugjatëve dhe azilkërkuese.
- Arritja e integritimit gjinor në të gjitha politikat dhe masat (përfshirë politikat rinore

## KUADRI KONCEPTUAL

Për qëllimet e kësaj analize, duhet të sqarohet konceptet sipas të cilat udhëhiqemi. *Gjinia përfshin rolet e ndërhuara shoqërore, sjelljet, aktivitetet, atributet dhe mundësitë që secila shoqëri i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat dhe njerëzit me identitete jo binare.* Gjinia është relacionale dhe tregon se si burrat/djemtë, gratë/vajzat dhe njerëzit me identitete jo binare ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe botën përreth tyre. Për shkak të ndërtimit të saj shoqëror, gjinia ndryshon në kontekste, hapësira dhe kohë, pasi individët ndërtojnë role dhe identitete të ndryshme që formësohen nga rrethana më të gjera ekonomike, politike dhe sociale (OBSH)<sup>16</sup>. Gjinia ndërvepron me, por dallon nga, *seksi që përfaqëson dallimet biologjike dhe fiziologjike midis burrave dhe grave.* Për shembull, dallimet në hormonet, dallimet në organet seksuale, etj. Megjithatë, si në shoqëri, ashtu edhe në këtë sondazh, gjinia dhe seksi janë kategori të ndërthurura dhe kuptimi i tyre varet nga perceptimet individuale të të anketuarve në sondazh. Gjinia dhe seksi janë të lidhura, por të ndryshme nga identiteti gjinor. *Identiteti gjinor i referohet përvojës së thellë, të brendshme dhe individuale të gjinisë së një personi, e cila mund ose nuk mund të korrespondojë me fiziologjinë e personit ose seksit të caktuar gjatë lindjes*<sup>17</sup>.

Barazia gjinore është një koncept në të cilin gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë kanë kushte, trajtim dhe mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre të plotë, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin dhe në mënyrë të barabartë të kontribuojnë drejt (dhe të përfitojnë nga) zhvillimit ekonomik, social, kulturor dhe politik. Barazia gjinore nënkupton që interesat, nevojat dhe përparësitë e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve merren parasysh, duke njohur diversitetin e grupeve të ndryshme dhe se të gjitha qeniet njerëzore janë të lira të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizimet e vendosura nga stereotipet dhe paragjykimet në lidhje me rolet gjinore<sup>18</sup>. Megjithatë, barazia gjinore mund t'i referohet edhe nocioneve më të gjera të barazisë në aspektin e identitetit gjinor (pritjet sociale dhe normat që lidhen me maskulinitetin dhe feminitetin) dhe orientimin seksual<sup>19</sup>.

Çdo individ ka besime, bindje, përvoja, aftësi, pamje të ndryshme, etj. Megjithatë, individë dhe grupe të caktuara kanë më shumë gjasa të përjetojnë stereotipe, paragjykime dhe diskriminim sesa individë dhe/ose grupe të caktuara për shkak të karakteristikave të caktuara. Ato mund të ndodhin për shkak të: gjinisë, seksit, identitetit ose shprehjes gjinore, aftësive/aftësive të kufizuara, moshës, statusit ekonomik, etnisë dhe/ose racës, origjinës kombëtare, pamjes fizike, përkatësisë fetare, etj. Stereotipet në të vërtetë burojnë nga strategjitë politike të konceptuara qartë - si rezultat i politikave të institucionalizuara të bazuara në stereotipe negative - (ndarja ekonomike - në lidhje me shtetin social - stereotipet për njerëzit e varfër, etj.).

16. Organizata Botërore e Shëndetësisë (2020), në dispozicion online në [https://www.who.int/health-topics/gender#tab=tab\\_1](https://www.who.int/health-topics/gender#tab=tab_1)

17. Ibid.

18. UNICEF 2017, online në <https://www.unicef.org/rosa/media/1761/file/Genderglossarytermsandconcepts.pdf>

19. Barazia gjinore dhe integrimi gjinor, Këshilli i Evropës, në dispozicion online në <https://www.coe.int/en/web/gender-matters/gender-equality-and-gender-mainstreaming#25>

Kjo analizë nxitet nga supozimi se pabarazitë gjinore në të gjitha fushat e jetës njerëzore shkaktohen kryesisht nga stereotipet dhe paragjykimet gjinore që formohen që në adoleshencë.

Stereotipi gjinor buron nga binari, domethënë vendosja e natyrës njerëzore si duale - arsyeja dhe emocionet, burri dhe gruaja, etj. Sipas Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), *"Stereotipet gjinore janë pikëpamje të përgjithësuara ose paragjykime për atributet ose karakteristikat, ose për rolet që janë ose duhet t'i kenë, ose t'i kryejnë gratë dhe burrat. Stereotipi gjinor është i dëmshëm kur kufizon aftësinë e grave dhe burrave për të zhvilluar aftësitë e tyre personale, për të ndjekur karrierën e tyre profesionale dhe/ose për të bërë zgjedhje për jetën e tyre*<sup>20</sup>.

Për qëllimet e këtij hulumtimi, do të përdorim një përkufizim më gjithëpërfshirës - *"Stereotipi gjinor përkufizohet si paracaktimi i karakteristikave, dallimeve dhe attributeve të një grupi të veçantë bazuar në gjininë e tyre. Stereotipet gjinore krijojnë paragjykime të pranuar gjerësisht për karakteristika ose tipare të caktuara dhe përjetësojnë idenë se secila gjini dhe sjelljet e lidhura janë binare. Sipas këtij supozimi, nëse një burrë ose grua vepron ndryshe nga mënyra se si pritet të sillen gjinia e tyre, ekziston përjashtimi nga shoqëria. Ndërsa shoqëria jonë lëviz drejt një konstruksioni më të gjerë të "çfarë do të thotë gjinia", individët që janë të mbërthyer në këtë ide binare të gjinisë e kanë të vështirë të kuptojnë individët që nuk përshtaten në dikotominë strikte gjinore ose nuk identifikohen me asnjë gjini*<sup>21</sup>. Stereotipet gjinoretë kombinuara me stereotipe të tjera kanë një ndikim negativ në mënyrë disproporcionale në grupe të caktuara njerëzish. Më poshtë janë paraqitur llojet themelore të stereotipeve gjinore<sup>22</sup> në një shoqëri heteronormative, binare:

- **Karakteristikat e personalitetit** - Për shembull, gratë shpesh pritet të jenë të adaptueshme dhe emocionale, ndërsa burrat zakonisht pritet të jenë të sigurt dhe agresivë.
- **Kujdesi për shtëpinë dhe familjen** - Për shembull, disa njerëz presin që gratë të kujdesen për fëmijët, të gatujnë dhe të pastrojnë shtëpinë, ndërsa burrat do të kujdesen për financat, të punojnë në makinë dhe të riparojnë pajisjet në shtëpi.
- **Profesionet** - Disa njerëz, bazuar në gjuhën e rrënjësor të pandjeshme ndaj gjinisë, shpejt supozojnë se mësuesit dhe infermierët janë gra dhe se pilotët, mjekët dhe inxhinierët janë burra.
- **Pamja fizike** - Për shembull, gratë pritet të jenë të holla dhe të hijshme, ndërsa burrat pritet të jenë të gjatë dhe muskuloz. Burrat dhe gratë gjithashtu pritet të vishen dhe të rregullohen në mënyra që janë stereotipike për gjininë e tyre - burrat veshin pantallona dhe kanë prerje të shkurtra flokësh, gratë janë të veshura me fustane dhe vënë grim).

20. Gender stereotyping - OHCHR and women's human rights and gender equality, online në <https://www.ohchr.org/en/women/gender-stereotyping>

21. Gender equality law centre, online në <https://www.genderequalitylaw.org/gender-stereotyping>

22. What are gender roles and stereotypes?, online në <https://www.plannedparenthood.org/learn/gender-identity/-sex-gender-identity/what-are-gender-roles-and-stereotypes>

Kur individët nuk janë në përputhje me stereotipet gjinore sociale, rezultati mund të çojë në diskriminim ose të krijojë trajtim të pabarabartë ose të padrejtë.

Në kuadër të këtij hulumtimi, paragjykimet përkufizohen si *“besime dhe qëndrime negative, të formuara në bazë të stereotipeve, të cilat nuk bazohen në njohuri dhe mendim serioz, por përfaqësojnë një mendim të pabazuar dhe të paargumentuar”*. Kjo analizë adreson llojet e mëposhtme të paragjykimeve:

- **Ablizam:** qëndrime negative të bazuara në aftësitë fizike dhe/ose intelektuale/paafësitë e individëve;
- **Racizëm:** qëndrime negative ndaj anëtarëve të një race, etnie dhe/ose kulture të caktuar;
- **Ejxhizam:** qëndrime negative bazuar në moshën/grup moshat, zakonisht që synojnë të rinjtë dhe/ose të moshuarit;
- **Ksenofobia:** pikëpamje negative për origjinën kombëtare të individëve dhe/ose grupeve;
- **Homofobia:** qëndrime negative ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTI+, etj.
- **Seksizmi:** qëndrime negative të bazuara në gjini, identitet gjinor dhe/ose shprehje gjinore të individëve.

Seksizmi dhe sjellja seksiste kryhen në nivel individual, institucional dhe strukturor dhe kanë një efekt të dëmshëm në të tre nivelet. Termi seksizëm rrjedh nga "vala e dytë" e feminizmit nga vitet 1960 deri në vitet 1980 dhe u përcaktua si *besimi se një gjini është superiore ose e lëndohet nga gjinia tjetër*. Stereotipet gjinore dhe paragjykimet e natyrshme formojnë normat, sjelljet dhe pritjet e burrave dhe djemve, dhe kjo çon në akte seksiste. Seksizmi është një pengesë për fuqizimin e grave dhe vajzave që janë të ndikuara në mënyrë disproporcionale nga sjellja seksiste. Koncepti i seksizmit u formulua fillimisht për të rritur ndërgjegjësimin për shtypjen e vajzave dhe grave, por në fillim të shekullit 21 u zgjerua në mënyrë që, brenda këtij hulumtimi, *seksizmi përfaqëson shtypjen bazuar në çdo gjini, përfshirë burrat dhe djemtë, njerëzit interseksualë dhe njerëzit transgjinorë*.

Stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimi shpesh lindin nga:

- Arsimi dhe edukimi patriarkal;
- Pabarazia në shoqëri;
- Idetë, supozimet, besimet dhe qëndrimet për njerëzit/grupet e tjera, zakonisht të fituara ose të mësuara nën ndikimin e familjes, miqve, bashkëmoshtarëve dhe/ose mediave;
- Mbyllja ndaj diversitetit, ndaj njerëzve që janë të ndryshëm nga ne, ideve të ndryshme, mënyrave të ndryshme të jetesës, etj.

*Diskriminimi gjinor ndodh kur një person trajtohet negativisht ose në mënyrë të pabarabartë, i mohohen mundësia dhe të drejta të caktuara dhe/ose paragjykohet në bazë të gjinisë ose identitetit gjinor të tij/saj.* Disavantazhi i grave dhe vajzave, nxënëseve, studenteve, atleteve, punëtoreve, vullnetareve, grave rome, grave anëtare të komunitetit LGBTI, grave viktime të dhunës me bazë gjinore në hapësirën online dhe offline, grave me aftësi të kufizuara, grave në pozita vendim-marrëse tregojnë nevojën për një qasje ndërsektoriale në trajtimin e pabarazive gjinore. Për të kuptuar pengesat dhe sfidat ekzistuese që lidhen me gjininë, moshën dhe marginalizimin me të cilat përballen palët e interesuara, në këtë hulumtim, gjinia shihet nga objektivi i kryqëzimit në mënyrë që të zhvillojë një kuptim të thellë të pabarazive sociale, duke përfshirë komunitetet dhe sistemet në të cilat jetojmë, arsimohemi, punojmë, ndërsa përmes karakteristikave të gjinisë, moshës dhe marginalizimit social.

Kjo analizë fokusohet tek të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç. Ne udhëhiqemi nga fakti se “të rinjtë” nuk janë një grup homogjen dhe se ka shumë nëngrupe në këtë kategori të gjerë moshe (gjegjësisht gra të reja përkundër burra të rinj, vajza adoleshente përkundër gra të reja dhe gra të reja me aftësi të kufizuara përkundër burra të rinj). Për të qenë efektiv në punën me të rinjtë në të gjithë diversitetin e tyre, ne duhet të punojmë për të kuptuar më mirë se kush janë ata në një kontekst të caktuar dhe të hartojmë dhe zbatojmë ndërhyrje të synuara që përpiqen t'u përgjigjen nevojave të tyre specifike.

Ndërsektorialiteti është i dobishëm për të kuptuar se si aspektet e identiteteve dhe statusit ekonomik, politik dhe shoqëror të individëve dhe grupeve mbivendosen për të krijuar përvoja të ndryshme të privilegjit, marginalizimit, diskriminimit dhe/ose cenueshmërisë. Shembuj të kategorive sociale që ndërthuren për të përcaktuar identitete të ndryshme përfshijnë gjininë, moshën, klasën, aftësinë e kufizuar, vendndodhjen gjeografike, statusin e migrimit, pamjen fizike, racën, fenë, seksualitetin dhe orientimin seksual. Këto kategori janë të ndërtuara nga shoqëria dhe janë dinamike, jo të lindura, që do të thotë se ato janë të ndryshueshme. Si një koncept i kryqëzuar, ndërsektorialiteti gjithashtu përqendrohet në çekuilibrimin e pushtetit midis grupeve shoqërore që riprodhohen dhe mirëmbahen përmes ligjeve dhe politikave ekonomike, politike dhe sociale, si dhe përmes organizatave dhe institucioneve. Ndërsektorialiteti ofron një kuptim më të plotë se si marginalizimi u shkakton disavantazh disa grupeve në krahasim me të tjerët dhe pse këto disavantazhe shoqërohen me kushte dhe rezultate të pafavorshme në shoqëri. Të gjitha format e pabarazisë përforcohen reciprokisht dhe për këtë arsye duhet të analizohen dhe adresohen njëkohësisht për të parandaluar që një formë e pabarazisë të përforcojë një tjetër.



# METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT

## Objektivat e hulumtimit

Qëllimi kryesor është të zbulohet se si mund të mbështesë dhe inkurajojë vajzat dhe gratë e reja të moshës 15 deri në 29 vjeç në Republikën e Maqedonisë së Veriut për t'u bërë më aktive në shoqëri dhe për të krijuar qasje të barabartë në mundësitë në jetën publike të vendit, në sektorin privat dhe kështu në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe kombëtar.

Analiza fokusohet në

- Nëse dhe sa të rinjtë janë të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe a e kuptojnë ata konceptin e barazisë gjinore;
- Cili është niveli i ndërgjegjësimit midis të rinjve për stereotipet dhe paragjykimet ekzistuese gjinore;
- Cilat janë burimet e paragjykimeve dhe stereotipeve gjinore;
- Nëse dhe në çfarë mase të rinjtë mbajnë stereotipet gjinore;
- Në cilat fusha të jetës janë më të përhapura stereotipet gjinore tek të rinjtë;
- Cilat janë përvojat personale të të rinjve me sjellje stereotipike gjinore të drejtuara ndaj tyre;

## Metodologjia e hulumtimit

Qasja metodologjike e përdorur gjatë hulumtimit dhe përgatitjes së analizës është analiza krahasuese, cilësore sasiore. Duke aplikuar krahasimin, kryqëzimin dhe përgjithësimin, formohen vlerësimet sasiore dhe cilësore, gjetjet dhe rezultatet, në përputhje me objektivat e kërkimit dhe analizës.

### Qasja metodologjike zbatohet përmes fazave të mëposhtme:

- Hulumtim në zyrë
- Hulumtim në terren
- Përpunim i analizës për perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve mbi pabarazinë gjinore, stereotipet dhe paragjykimet

#### 1. Hulumtim në zyrë

Kjo fazë përfshin një analizë të politikave aktuale, dokumenteve dhe rezultateve në fushën e pabarazisë gjinore midis të rinjve, në shoqëri, por edhe në kuadër të projektit. Qëllimi është, ndër të tjera, të përcaktojë palët e interesuara brenda këtij fenomeni social, situatën aktuale dhe aktivitetet e zbatuara në këtë kontekst dhe të vendosë një bazë të përshtatshme dhe solide për kryerjen e hulumtimit dhe përpilimin e Analizës së (pa)barazisë gjinore përmes prizmit të të

rinjve. Në vete përfshinte analizën e përmbajtjes së kuadrit ligjor të përzgjedhur kombëtar dhe ndërkombëtar, standardet dhe programet, analizat, raportet në lidhje me të rinjtë, pabarazinë dhe çështjet gjithëpërfshirëse.

## **2. Hulumtim në terren**

Plani i detajuar i hulumtimit zhvillohet në fazën përgatitore dhe në marrëveshje me ekipin e projektit. Sondazhi u krye përmes shpërndarjes së një pyetësoi dhe mbajtjes së grupeve të fokusit.

### **● PYETËSOR**

Aktiviteti kërkimor u krye në terren duke përdorur një pyetësor të strukturuar për anketë (shih Shtojcën Nr.1). Aktiviteti u krye përmes hulumtimit në terren duke përdorur teknikën anketë, me plotësimin e pyetësorëve individualë për secilin të anketuar nga mostra: të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç.

Pyetësoi përmban pyetje të mbyllura, me opsione për zgjedhjen e përgjigjeve, të cilat i referohen stereotipeve gjinore tek të rinjtë, paragjykimeve gjinore tek të rinjtë, burimeve nga e kanë origjinën paragjykimet dhe stereotipet gjinore, krijimi dhe përhapja e paragjykimeve dhe stereotipeve (shkolla, fakultete, institucione, familja, rrethi social, vendi i punës etj.), modelet e komunikimit dhe modelet sociale për inkurajimin dhe fuqizimin e vajzave dhe grave të reja, nevojat e grave dhe vajzave të reja për përfshirje aktive në shoqëri, kanalet e komunikimit të preferuara nga të rinjtë me fokus vajzat dhe femrat. Njëkohësisht përmbajnë edhe pyetje, me specifikat e nevojave të të rinjve sipas grupmoshës së cilës i përkasin.

Qëllimi i aktivitetit është të marrë një vlerësim sasior të perceptimeve dhe nevojave të të rinjve për pabarazinë rinore, duke mbuluar grupet e mësipërme të çështjeve, sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe vendbanimit – rajonit, mjedisit urban ose rural të të anketuarve.

Gjithsej 1 200 të rinj të moshës 15 deri në 29 vjeç, nga të cilët 634 gra të reja dhe 566 burra të rinj. Sa i përket përfaqësimit të bashkësive etnike, të anketuarit u përkisnin bashkësive etnike të: maqedonasve, shqiptarëve, romëve, turqve, vllahëve, serbëve, boshnjakëve, etj.

### **● GRUPET E FOKUSIT**

Ky aktivitet kërkimor u zhvillua në të tetë rajonet planore, duke organizuar gjithsej 24 grupe fokusi (tre grupe fokusi në secilin rajon):

1. Grupi i fokusit (4 vajza dhe 4 djem) të moshës 15 deri në 18 vjeç
2. Fokus grupi (4 vajza dhe 4 djem) të moshës 19 deri në 23 vjeç
3. Grupi i fokusit (4 gra të reja dhe 4 burra të rinj) të moshës 24 deri në 29 vjeç.

Diskutimet u zhvilluan në një përbërje të përzier gjinore për të ndarë dhe parë perspektivat dhe përvojat e të anketuarve në drejtim të pabarazisë midis të rinjve nga një perspektivë gjinore.

Në marrëveshje me ekipin e projektit, përbërja e pjesëmarrësve u përcaktua më tej në lidhje me karakteristikat e tjera të të anketuarve, përveç gjinisë (përkatësia etnike, fetare, statusi social, arsimi i përfunduar, vendbanimi urban ose rural, etj.).

Qëllimi është të sigurohet një vlerësim cilësor i perceptimeve dhe përvojave të të rinjve të grup moshave të ndryshme mbi pabarazinë e të rinjve, me përfshirjen e stereotipeve gjinore midis të rinjve, paragjykimet gjinore midis të rinjve, burimet ku lindin paragjykimet dhe stereotipet gjinore, krijimi dhe përhapja e paragjykimeve dhe stereotipeve (shkollat, fakultetet, institucionet, familja, rrethi i miqve, vendi i punës, etj.), modelet e komunikimit dhe modelet sociale për të inkurajuar dhe fuqizuar vajzat dhe gratë e reja, nevojat e vajzave dhe grave të reja për përfshirje aktive në shoqëri, kanalet e komunikimit të preferuara nga të rinjtë me fokus vajzat dhe gratë. Në fokus grupet u përfshinë gjithsej 192 të anketuar, 96 burra të rinj dhe 96 gra të reja.

### ***3. Përpunimi i Analizës për pabarazisë mes të rinjve***

Pas kryerjes së aktiviteteve kërkimore, ekipi hulumtues paraqiti të dhënat e marra nga hulumtimi në një dokument më të gjerë. Për të përgatitur një analizë gjithëpërfshirëse gjinore të perceptimeve të stereotipeve gjinore, paragjykimeve dhe pabarazive të të rinjve në Maqedoninë e Veriut, u angazhua një ekspert gjinor. Analiza e (pa)barazisë gjinore përmes prizmit të të rinjve në Maqedoninë e Veriut ofron përgjigje në pyetjet e mëposhtme:

- Nëse dhe sa të rinjtë janë të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe a e kuptojnë ata konceptin e barazisë gjinore;
- Cili është niveli i ndërgjegjësimit midis të rinjve për stereotipet dhe paragjykimet ekzistuese gjinore;
- Cilat janë burimet e paragjykimeve dhe stereotipeve gjinore;
- Nëse dhe në çfarë mase të rinjtë mbajnë stereotipet gjinore;
- Në cilat fusha të jetës janë më të përhapura stereotipet gjinore tek të rinjtë;
- Cilat janë përvojat personale të të rinjve me sjellje stereotipike gjinore të drejtuara ndaj tyre;

## PARIMET ETIKE NË HULUMTIMIN DHE ANALIZËN E REALIZUAR

Ekipi i ekspertëve, së bashku dhe në bashkëpunim me ekipin e projektit dhe koordinatorët dhe hulumtuesit në terren, udhëhoqën dhe zbatuan aktivitetet sipas parimeve themelore të praktikës shkencore dhe etikës në veprimtarinë shkencore dhe kërkimore; përkatësisht, u udhëhoqën dhe zbatuan parimet e mëposhtme:

- Vërtetësia: të dhënat e siguruara u morën, përpunuan dhe interpretuan me saktësi, në mënyrë precize, të vërtetë dhe autentike (pa shtuar dhe/ose modifikuar të dhënat).
- Përgjegjësi: Eksperti dhe menaxheri i projektit janë plotësisht përgjegjës për hulumtimin e kryer. Ata tregojnë përgjegjësi në mënyrë që të jenë vazhdimisht të vetëdijshëm se rezultatet e hulumtimit mund të përdoren për qëllime të ndryshme dhe nga ata që marrin vendime dhe veprojnë pozitivisht në shoqëri, por edhe nga ata që veprojnë negativisht dhe mund të bëjnë keqpërdorim, përdorim të gabuar dhe interpretim të rezultateve.
- Konfidencialiteti: secili nga pjesëmarrësit ishte i përfshirë në aktivitetet kërkimore me pëlqimin e tij/saj (pjesëmarrësit e mitur ishin të përfshirë me pëlqimin e dhënë nga prindërit/kujdestarët e tyre). Të gjitha të dhënat e marra dhe të ndara trajtohen dhe ruhen në mënyrë konfidenciale, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta Zyrtare nr. 42/20, 294/21) .• Integriteti: Ekipi i ekspertëve i analizoi të dhënat në masën dhe saktësinë e kërkuar dhe i paraqiti të dhënat e siguruara në mënyrë të plotë, të saktë, të ndershme dhe korrekte.
- Liria: Ekipi i ekspertëve udhëhiqet nga qëllimet e hulumtimit, duke zbatuar parimet e lirisë së hulumtimit, si një nga shprehjet më të rëndësishme të rregullimit demokratik. Ekipi i ekspertëve ka detyrimin të koordinojë punën dhe të kujdeset për çdo të anketuar, duke respektuar dinjitetin dhe lirinë e tyre, si dhe të drejtën e fjalës.
- Bashkëpunimi: Gjatë zbatimit të të gjitha aktiviteteve, ekipi i ekspertëve kultivoi dhe praktikoi bashkëpunim pozitiv me ekipin e projektit dhe koordinatorët lokalë të përfshirë në aktivitetet e projektit.
- Profesionalizëm: Ekipi i ekspertëve realizoi të gjitha aktivitetet në mënyrë krejtësisht profesionale, racionale, duke përdorur njohuritë e tyre nga fusha e tyre e ekspertizës, duke ndarë vlerat dhe parimet e kërkimit shkencor me të gjithë ata që janë të përfshirë në aktivitetet hulumtuese dhe kërkimore.

## GJETJET KRYESORE

---

- Më shumë se 90% e të rinjve, pavarësisht nga gjinia, kanë dëgjuar për termin barazi gjinore, por ende nuk janë mjaft të njohur me kuptimin e saj.
- Çdo i treti i ri beson se në shoqërinë tonë burrat dhe gratë kanë trajtim të barabartë, domethënë, nuk ka pabarazi gjinore për ta.
- Për 59.3% të të rinjve të anketuar, burrat dhe gratë nuk kanë trajtim të barabartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shumica e grave të reja 63.1%, si dhe më shumë se gjysma e burrave të rinj 55.1% besojnë se nuk ka barazi gjinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Ndërgjegjësimi për stereotipet gjinore është zhvilluar në mesin e të rinjve. Raporti i të rinjve të cilët konsiderojnë se në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë stereotipe gjinore përkundër atyre që janë të bindur se nuk ekzistojnë ose nuk i njohin ato është 3 me 1.
- Shumica e të anketuarve nga komuniteti etnik shqiptare dhe maqedonase janë të vetëdijshëm për dëmin e stereotipeve gjinore, por çdo i treti i anketuar nga grupi etnik rom nuk është i vetëdijshëm ose nuk e di nëse stereotipet gjinore janë të dëmshme për përparimin në shoqëri.
- Çdo i treti i ri ka përjetuar personalisht sjellje stereotipike gjinore dhe ndikime negative prej saj, dhe më shpesh stereotipet gjinore përjetohej nga gratë e reja.
- Sjellja stereotipike gjinore përjetohej më shpesh nga të rinjtë nga komunitetet etnike të pakicave, kështu që çdo i anketuar i dytë me përkatësi etnike rome dhe shqiptare personalisht ishte prekur nga ndikimet negative të stereotipeve gjinore.
- 65.4% e të rinjve besojnë se stereotipet gjinore janë të pranishme në mjedisin e tyre më të afërt.
- Për sa i përket vendit ku mësojnë, dëgjojnë, shohin stereotipet gjinore dhe ku të rinjtë mendojnë se shfaqen më shpesh, rrethi familjar vjen i pari, pasuar nga mediat sociale dhe institucionet arsimore.
- Vajzat kanë më shumë gjasa të vërejnë stereotipe gjinore që ndikojnë në mënyrë disproporcionale në procesin arsimor.
- Gratë e reja janë më pak të ndjeshme ndaj stereotipeve gjinore sesa burrat e rinj.
- Shumica e të anketuarave 67.2% dhe 57.4% e të anketuarave besojnë se bazuar në pamjen e tyre fizike, gratë nuk kanë trajtim të barabartë, ndërsa 52.8% e të anketuarave dhe 56.8% e të anketuarave konsiderojnë të njëjtën gjë për burrat.

## GJETJET KRYESORE

---

- Më shumë se gjysma (60%) e të anketuarave besojnë se djemtë/burrat dhe vajzat/gratë kanë qasje të barabartë në mundësitë arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- 17.6% e numrit të përgjithshëm të të anketuarave nuk janë inkurajuar nga anëtarët e familjes së tyre për të vazhduar arsimin dhe për të përfunduar një shkallë më të lartë të arsimit.
- Më shumë se gjysma e të rinjve të anketuar nuk janë të vetëdijshëm për ekzistencën e roleve gjinore, stereotipeve dhe paragjykimeve që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit ose zgjedhjen e kandidatit/es nga punëdhënësit. 39.5% e të anketuarave besojnë se do të kishin vështirësi në gjetjen e një pune.
- Besimet më stereotipike gjinore në mesin e të rinjve ka në aspektin e aktivitetit politik dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.


# ANALIZA GJINORE E PERCEPTIMEVE TË STEREOTIPEVE GJINORE, PARAGJYKIMEVE DHE PABARAZIVE TË TË RINJVE NË MAQEDONINË E VERIUT

---

# SA ËSHTË VETËDIJA E TË RINJVE PËR (PA)BARAZINË GJINORE?

Indeksi i Barazisë Gjinore në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 është 64.5 pikë nga maksimumi 100 dhe ka një përparim prej 2.5 pikë në krahasim me matjen e fundit në vitin 2019, dhe është pozicionuar 3.5 pikë prapa mesatares së Shteteve Anëtare të BE-së (BE-27)<sup>23</sup>. Në vitin 2022, krahasuar me shtetet anëtare të BE-së, Maqedonia e Veriut renditet e katërmbëdhjeta, midis Italisë (15) dhe Maltës (13), dhe krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor - Serbia, Shqipëria dhe Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut ka marrë numrin më të madh të pikëve<sup>24</sup>. Megjithatë, lëvizja kundër gjinisë, si në nivel global ashtu edhe në vendin tonë, po merr një kthesë më të madhe, e cila do të lërë pasojë të qëndrueshme në përparimin që Maqedonia e Veriut ka bërë në aspektin e barazisë gjinore në 10 vitet e fundit.

Nga 1205 njerëz të anketuar, 91.3% e burrave të rinj dhe 90.7% e grave të reja kishin dëgjuar për termin barazi gjinore, pjesa tjetër nuk kishin dëgjuar ose nuk ishin të sigurt nëse e kishin hasur termin. Barazia gjinore është më pak e njohur si term për romët e rinj 77.5%, ndërsa për më shumë se 90% të të anketuarve të etnisë maqedonase dhe shqiptare termi është i njohur. Shumica e të rinjve nga rajoni i Pollogut kanë dëgjuar për barazinë gjinore – 99.5%, ndërsa më pak të rinjtë nga rajoni i Shkupit - 84.3%.



**Grafiku 4.** Njohja e të anketuarve me termin barazi gjinore

23. M.Bashevka, Indeksi i barazisë gjinore në Maqedoninë e Veriut 2022 - Matja e barazisë gjinore [https://www.stat.gov.mk/-publikacii/2023/Gender-Index-2022\\_MK-web.pdf](https://www.stat.gov.mk/-publikacii/2023/Gender-Index-2022_MK-web.pdf)

24. Ibid.



Megjithëse të anketuarit/anketuarat kishin dëgjuar për termin barazi gjinore, për të vlerësuar se si e kuptonin, u pyetën se çfarë do të thotë barazi gjinore. Për pjesën më të madhe, nga 85% të të anketuarve të rinj dhe të anketuarave, barazia gjinore nënkupton gjithashtu përfaqësim të drejtë gjinor. Përfaqësimi i drejtë gjinor është një proces me të cilin arrihet barazia gjinore, megjithatë, ky është një term që shumë shpesh identifikohet dhe përdoret si sinonim në publik. Pak më shumë se 80% e të rinjve dhe të anketuarve dhe të anketuarave besojnë se barazia gjinore nënkupton barazinë ligjore, politike dhe sociale të gjinive, ndërsa për 76.3% gra dhe 80.4% burra barazia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë kanë të njëjtat të drejta.

Për pothuajse 82% të të rinjve, barazia gjinore nënkupton gjithashtu qasje të barabartë në burime dhe mundësi, pavarësisht nga gjinia dhe seksi, ndërsa për pothuajse 83% të tyre, barazia gjinore do të thotë gjithashtu qasje dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje ekonomike dhe pjesëmarrje në vendimmarrje si për burrat ashtu edhe për gratë. Përsëri, për një 80% të lartë të të anketuarve/anketuarave pavarësisht nga gjinia, vlerësimi i sjelljeve, aspiratave dhe nevojave të ndryshme çon në barazi gjinore. Lidhur me atë nëse qasja në mbrojtje është parakusht për barazinë gjinore, vetëm 64.7% e të anketuarave dhe 70.7% e të anketuarve pajtohen, ndërsa 19% nuk e dinë nëse qasja e barabartë në mbrojtje do të përmirësonte barazinë gjinore. Shqetësues është fakti që për 1/3 e të anketuarve të rinj dhe 23.7% të të anketuarave të reja, një shoqëri e barabartë gjinore është gjithashtu ajo në të cilën vajzat dhe djemtë ose gratë dhe burrat nuk kanë të njëjtat mundësi.

Nga këto rezultate mund të konkludojmë se edhe pse më shumë se 90% e të rinjve kanë dëgjuar për termin barazi gjinore, ende rreth 20-25% e të anketuarve, përkatësisht 1/5 e të rinjve, nuk janë mjaftueshëm të njohur me kuptimin dhe thelbin e konceptit të barazisë gjinore. Megjithëse të rinjtë janë pjesërisht të vetëdijshëm për përfitimet e barazisë gjinore, përkatësisht cilat janë kushtet që një shoqëri duhet të plotësojë për të arritur barazinë e plotë gjinore, informacioni është i paplotë dhe ekziston nevoja për rritjen e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit gjinor të të rinjve.

Pabarazia gjinore është diskriminimi i bazuar në bazë të seksit ose gjinisë që shkakton që një gjini ose seks, të privilegjohet në mënyrë rutinore ose t'i jepet përparësi në raport me gjininë dhe seksin tjetër. Për shumicën e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut 78.5%, pothuajse numër i barabartë i të rinjve të të dy gjinive, pabarazia gjinore çon në diskriminim. Ky qëndrim është më i përfaqësuar në mesin e të rinjve të etnisë shqiptare (85.3%). Megjithatë, 14.2% e numrit të përgjithshëm të të rinjve të anketuar nuk kanë një qëndrim mbi pyetjen nëse pabarazia gjinore çon në diskriminim. Pavarësisht nga pabarazia e dukshme në pjesëmarrjen në tregun e punës, hendeku gjinor i pagave, zgjedhjet e arsimit stereotipik gjinor (dhe profesionet e mëvonshme), ndarja e pabarabartë e obligimeve në shtëpi, pjesëmarrja e pabarabartë e grave në pozicionet vendimmarrëse, është shqetësuese që ½ e të anketuarave konsiderojnë se gratë dhe burrat kanë trajtim të barabartë, dhe këtë bindje e kanë edhe për 8.4% më shumë burra të rinj, përkatësisht çdo i treti burrë i ri.

Megjithatë për gjysmën, përkatësisht 59.3% të të rinjve të anketuar, burrat dhe gratë nuk kanë trajtim të barabartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shumica e grave të reja 63.1%, si dhe më shumë se gjysma e burrave të rinj 55.1% besojnë se burrat dhe gratë nuk kanë trajtim të barabartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Statistikat shtetërore<sup>25</sup> tregojnë se gratë preken në mënyrë disproporcionale nga pabarazitë gjinore në pothuajse të gjitha sferat dhe fushat e jetës, por edhe në çdo grup moshë.

---

25. Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut: Një portret statistikor i tendencave në fushën e barazisë gjinore, UN Women 2022, në dispozicion online në [https://www.stat.gov.mk/Publikacii/2022/MK\\_WandM-NMK-Report\\_WEB\\_0.pdf](https://www.stat.gov.mk/Publikacii/2022/MK_WandM-NMK-Report_WEB_0.pdf)

## STEREOTIPET GJINORE: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PËRVOJAT E TË RINJVE

Të rinjtë janë të ekspozuar ndaj stereotipeve dhe stereotipizimit. Shumë të rinj jetojnë në mjedise ku ata preken çdo ditë nga stereotipet tradicionale mashkullore ose femërore. Prania e stereotipeve dhe paragjykimeve gjinore rreth dhe midis të rinjve pengon dhe kufizon qasjen e tyre në çdo barazi të pozitës ose statusit në shoqëri; stereotipet dhe paragjykimet gjinore mund të jenë pengesa për arritjen e qëllimeve të tjera për barazinë rinore. Qasja në vendimmarrje po bëhet gjithnjë e më e vështirë dhe e padisponueshme. Në fund, prania e stereotipeve dhe paragjykimeve gjinore mund të ndikojë në qasjen drejt burimeve të të rinjve, veçanërisht vajzave dhe grave të reja, duke u përballur me situata në të cilat ato nuk kanë zë në vendimmarrje dhe /ose në situata ku nuk gëzojnë të drejta, respekt dhe mbështetje.

Stereotipet janë forma historike dhe janë produkt i vetëdijes kolektive, kështu që ato zakonisht për to nuk mendohen kur përdoren, por pranohen si të vërteta të dhëna përjetësisht të vërteta. Religjionet tradicionale kanë kontribuar dhe ende kontribuojnë në pabarazinë gjinore në krijimin e stereotipeve gjinore dhe në diskriminimin dhe përjashtimin e grave. Si në rajonin më të gjerë të Ballkanit ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, stereotipet gjinore janë të rrënjësura thellë në sistem,<sup>26</sup> traditat, kulturë dhe religjion,<sup>27</sup> kështu që në valën e lëvizjeve anti-gender, figurat publike, udhëheqësit fetarë dhe politikanët konservatorë shpesh dalin në publik dhe u tregojnë grave se ku "e kanë vendin", si dhe cili është roli patriarkal i burrit dhe kështu bëjnë thirrje për ruajtjen e stereotipeve gjinore. Përveç kësaj, megjithëse është bërë përparim, mediat dhe punonjësit e mediave nuk janë mjaft të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe kështu në tekstet dhe emisionet e tyre i mbushin përmbajtjet me stereotipe gjinore. Tekstet shkollorë për arsimin fillor në vitet e kaluara ishin subjekt i analizës gjinore, ku u përcaktua prania e stereotipeve të shumta në lidhje me rolet dhe marrëdhëniet mashkullore dhe femërore në tekstet shkollorë për gjuhë maqedonase, etikë,<sup>28</sup> art, shoqëri, etj.<sup>29</sup>

Të rinjtë në Maqedoninë e Veriut njohin dhe përpiqen të mos ndjekin ose zhdukin stereotipet gjinore. Zakonisht i njohin kur përjetojnë sjellje stereotipike

26. D.Drndarevska, Analiza e përfaqësimit të gjinisë, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në tekstin shkollor "Etika në religjionet" për klasën V, Gratë si agjente në religjion, në dispozicion [https://mtspresursencentar.mk/publication/4914\\_Publication%2020-%20final.pdf](https://mtspresursencentar.mk/publication/4914_Publication%2020-%20final.pdf)

27. Homofobia dhe seksizmi në mediat në Ballkanin Perëndimor, (2021) ICS, <https://iks.edu.mk/novosti/homofobijata-i-seksizmot-vo-mediumite-na-zapaden-balkan/>

Prof. dr. Dubravka Valiq Nedeljkoviq, Duke gjykuar nga media, gratë në Ballkan jetojnë vetëm në skenë (2019) <https://respublika.edu.mk/blog/politika/2019-04-05-07-48-25/>

28. Prifti Petar: Gratë janë fajtoresh për divorcet (2013) <https://a1on.mk/macedonia/vladika-petar-zhenite-se-vinovni-za-raz/> ;

Përgjigje e At Jakov Stobiski ndaj Ministrit (2023) [https://www.zadecata.org/post/otec\\_jakov\\_do\\_trencevska](https://www.zadecata.org/post/otec_jakov_do_trencevska)


Reagimi i Platformës për Barazi Gjinore: Kërcënimet me jetë nuk janë liri e shprehjes! Solidaritet me aktivistët dhe gazetarët Rita Behadini! (2023) <https://rodovaplatforma.mk/blog/2023/07/25/%d1%80%d0%b5%d0%b0%d0%ba%d1%86%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%bd%d0%b0-%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d1%82%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0%d1%82%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d1%80%d0%be%d0%b4%d0%be%d0%b2%d0%b0-%d0%b5%d0%b4%d0%bd-4/>

29. Postimet seksiste të mediave: Komiteti i Helsinkit paraqet ankesa (2019) <https://faktor.mk/seksistichki-objavi-od-mediumi-helsinshki-komitet-podnese-pretstavki>

gjinore të drejtuara ndaj tyre personalisht, ndërsa gratë e reja janë më shpesh objektiv i sjelljes stereotipike gjinore. Adoleshentët e moshës 15-19 vjeç më pak njohin stereotipet gjinore në shoqëri, por megjithatë janë të vetëdijshme se ato ekzistojnë në mjedisin e tyre të ngushtë. Komunitetet etnike të pakicave gjithashtu preken më shpesh nga ndikimet negative të stereotipeve gjinore, përkatësisht, çdo anëtar i dytë i një grupi etnik rom dhe shqiptar, në krahasim me çdo anëtar i tretë i një grupi etnik maqedonas.

Kur bëhet fjalë për njohjen e stereotipeve gjinore dhe kuptimin e tyre, 83.9% e burrave të rinj dhe 84.2% e grave të reja janë të njohura me termin, ndërsa 16.1% e të anketuarve dhe 15.7% e të anketuarave nuk kanë dëgjuar për termin ose nuk e dinë. Shumica e të rinjve, pavarësisht nga vendbanimi i tyre, mjedis urban ose rural, kanë dëgjuar për stereotipet gjinore.

### *Përqindja e njohjes së termit stereotipe gjinore, sipas etnisë së të anketuarve/anketuarave*



**Grafiku 5** Përqindja e (mos)njuhjes me termin stereotipet gjinore, sipas etnisë së të anketuarve

Një përqindje e lartë prej 95.8% e të anketuarve të etnisë turke, 86.7% e të anketuarve të etnisë shqiptare, 83.6% e të anketuarve të etnisë maqedonase dhe 62.5% e të anketuarve të etnisë rome kanë dëgjuar për stereotipet gjinore.


Raporti i të rinjve të cilët konsiderojnë se në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë stereotipe gjinore përkundër atyre që janë të bindur se nuk ekzistojnë ose nuk i njohin ato është 3 me 1. Shumica e të rinjve, pavarësisht nëse jetojnë në një mjedis urban ose rural, përkatësisht 76.8% e të anketuarve dhe të anketuarave besojnë se ekzistojnë stereotipe gjinore në Maqedoninë e Veriut. Në një numër shumë të vogël ose 5.4% e të anketuarve dhe të anketuarave besojnë se nuk ka stereotipe gjinore në Maqedoninë e Veriut ndërsa 15.4% nuk janë të njohur. Vajzat janë më të vetëdijshme për stereotipet gjinore në vend sesa djemtë. 81.1% e të anketuarave dhe 76.9% e të anketuarave besojnë se stereotipet gjinore ekzistojnë në Maqedoninë e Veriut. Vetëm 3.9% e të anketuarave dhe 7.1% e të anketuarave mohojnë ekzistencën e stereotipeve gjinore.

Pothuajse një e pesta e adoleshentëve të moshës 15-19 vjeç, ose 18.3%, nuk janë të njohur me ekzistencën e stereotipeve gjinore në Maqedoninë e Veriut. Kjo përqindje e të anketuarve dhe të anketuarave të moshës 25-29 vjeç është 16.5% ndërsa te mosha 20-24 vjeç është 11.5%. Përveç kësaj, vetëm 65.2% e të rinjve në Rajonin Juglindor mendojnë se stereotipet gjinore janë mbizotëruese në shtet.

Ndërsa shumica e të anketuarve/anketuarave nga komunitete të ndryshme etnike janë të vetëdijshëm për ekzistencën e stereotipeve gjinore. Megjithëse ato janë një nga grupet etnike të shënjestruara nga një numër i madh stereotipesh dhe paragjykimesh në Maqedoninë e Veriut, ndërkaq vajzat rome janë stereotipizuar dhe kështu diskriminohen mbi më shumë baza, një e treta ose 32.5% e të anketuarve të rinj të etnisë rome nuk janë të njohur me ekzistencën e stereotipeve gjinore ose nuk e kuptojnë mjaftueshëm terminologjinë.

Edhe pse shumica e të rinjve besojnë se stereotipet gjinore janë të pranishme kudo në jetën e përditshme në Maqedoninë e Veriut, vetëm 65.4% e të rinjve besojnë se stereotipet gjinore janë të pranishme në mjedisin e tyre. Një në pesë të anketuar/anketuarara beson se stereotipet gjinore nuk janë të pranishme në mesin e të afërmeve, miqve, në shkollë, në punë, etj. Ajo që është interesante është se më shumë të anketuara femra janë të bindur në këtë, edhe pse gratë i ndjejnë efektet negative të stereotipeve gjinore shumë më tepër. 15.9% e të rinjve nuk i njohin stereotipet gjinore në mjedisin e tyre.

**Vallë dhe sa stereotipet gjinore janë të pranishme në mjedisin e të anketuarve/të anketuarave?**




**Grafiku 6:** Niveli i prezencës së stereotipeve gjinore në mjedisin e të rinjve

Megjithëse një në pesë adoleshentë besonin se nuk ka stereotipe gjinore në Maqedoninë e Veriut, 4 në 5 adoleshentë thonë se stereotipet gjinore janë pjesërisht ose plotësisht të pranishme midis miqve, familjes, shkollës dhe rrethinës tjetër të tyre të ngushtë. Përveç kësaj, shumica e të anketuarve/anketuarave nga të gjitha komunitetet etnike njohin dhe theksojnë stereotipet gjinore që hasin në mjedisin e tyre.

Të rinjtë nuk janë imunë ndaj stereotipeve gjinore dhe 75% e tyre janë të vetëdijshëm për efektet e tyre të dëmshme në përparimin e shoqërisë, pa dallime më të mëdha midis të anketuarve meshkuj dhe femra.

Ndërkaq që shumica e të anketuarve nga komuniteti etnik shqiptare dhe maqedonase janë të vetëdijshëm për dëmin e stereotipeve gjinore, por çdo i tretë i anketuar nga grupi etnik rom nuk është i vetëdijshëm ose nuk e di nëse stereotipet gjinore janë të dëmshme për përparimin në shoqëri.



Grafiku 7 Dëmi nga stereotipet gjinore

Rrjedhimisht, 75.2% e të rinjve në Maqedoninë e Veriut nuk mbështesin stereotipet gjinore, ndërsa 9.7% e të anketuarve dhe të anketuarave i mbështesin dhe i praktikojnë ato me vetëdije. Për 7.7% më shumë të anketuar meshkuj sesa femra mbështetën stereotipet gjinore.

Fakti që shumica e të rinjve mendojnë se stereotipet gjinore janë të dëmshme dhe nuk mbështesin mbijetesën e tyre varet në një farë mase nga përvojat e tyre personale. Një total prej 40.9% e grave të reja të anketuara kanë përjetuar stereotipe gjinore dhe sjellje stereotipike gjinore, ndërsa nga numri i përgjithshëm i burrave, 38.9% kanë pasur përvojë të ngjashme. Duke pasur parasysh se afërsisht e njëjta përqindje e të anketuarve / anketuarave nuk e dinin se cilat janë stereotipet gjinore, 14.7% e burrave të rinj dhe 11.4% e grave të reja nuk e dinë nëse deri më tani janë përballur me ndikime negative në jetën e tyre të shkaktuara nga stereotipet gjinore. Shumica e të anketuarve të rinj, 46.5% burra të rinj dhe 47.8% gra të reja, konsiderojnë se nuk kanë përjetuar personalisht sjellje stereotipike gjinore. Nga kjo mund të konkludojmë se çdo i treti i ri ka përjetuar personalisht sjellje stereotipike gjinore dhe ndikime negative prej saj, dhe më shpesh stereotipet gjinore përjetohej nga gratë e reja.


Të anketuarit e rinj/të anketuarat e reja të moshës 20-24 vjeç, kryesisht kanë përjetuar sjellje stereotipike gjinore përkatësisht 44.4%, ndërsa pas tyre vijojnë të rinjtë e moshës 25-29 vjeç, nga të cilët 40.3% kanë përjetuar personalisht/përjetojnë stereotipe gjinore. Grupi me përvojën më pak personale me sjelljet stereotipike gjinore ka më pak njohuri për kuptimin dhe ekzistencën e stereotipeve gjinore, dhe këta janë adoleshentët me 34.8%. Në vitet e reja të jetës së tyre, megjithëse njerëzit janë më të rrethuar nga stereotipet në edukim dhe arsim, ata ende nuk i njohin mjaftueshëm stereotipet, por i shohin ato si rregulla, udhëzime, udhërrëfyes të dhëna nga mjedisi i tyre i ngushtë të cilat duhet t'i respektojnë. Sjellja stereotipike gjinore përjetohej më shpesh nga të rinjtë nga komunitetet etnike të pakicave, kështu që pothuajse një përqindje e barabartë ose gjysma e të rinjve të anketuar nga etnia rome (50%) dhe pothuajse gjysma e të rinjve të anketuar nga etnia shqiptare (49.3%) kanë përjetuar personalisht/përjetojnë stereotipe gjinore. Pak më shumë se një e treta ose 35.7% e të anketuarve të rinj të etnisë maqedonase kanë përjetuar personalisht/po përjetojnë stereotipe gjinore.

Për sa i përket vendit ku mësojnë, dëgjojnë, shohin stereotipet gjinore dhe ku të rinjtë mendojnë se shfaqen më shpesh, rrethi familjar është i pari. Besimet dhe udhëzimet se si duhet të sillen djemtë dhe vajzat, çfarë duhet të pëlqejnë/mos pëlqejnë të fillojnë që në moshë të re, në rrethin familjar: “Djemtë nuk qajnë”, “Vajzat luajnë me kukulla dhe barbi, jo me karroca”, “Ti je vajzë, duhet të veshësh fustan”, “Djemtë të ngacmojnë sepse të pëlqejnë”, “Djemtë luajnë futboll, jo balet”, etj. Çdo i dyti i anketuar/ e anketuar beson se stereotipet gjinore shfaqen së pari dhe mësohen nga anëtarët e familjes. 8.7% e të anketuarve besojnë se familjet janë vendet ku stereotipet gjinore ndodhin më shpesh. Një 85% e lartë e të anketuarve nga komuniteti etnik rom besojnë se familja është vendi ku stereotipet gjinore ndodhin më shpesh. Të njëjtin qëndrim ndajnë 60% e të rinjve të anketuar/anketuara të etnisë shqiptare dhe 44.9% e të rinjve të etnisë maqedonase.

*„Familja është vendi kryesor ku ne mësojmë dhe kuptojmë botën. Kështu, stereotipet dhe paragjykimet gjinore më shumë i hasim këtu.” (Vajzë, 20-24 vjeç).*

Për 44.3% të të anketuarve të rinj dhe të anketuarve të reja, stereotipet gjinore më së shpeshti shfaqen në mediat sociale, si Facebook, Instagram, TikTok. Është interesante se për një numër të barabartë djemsh të rinj krijohen stereotipe gjinore në familje dhe në mediat sociale, dhe media sociale është hapësira e dytë më e zakonshme në të cilën shfaqen stereotipe gjinore edhe për gratë e reja. Gjeneratat e reja, veçanërisht të rinjtë e moshës 15-19 vjeç, janë gjithashtu përdorues të mediave sociale që në moshë të re, kështu mësimi rreth stereotipeve gjinore mund të lidhet me përmbajtjen që ata shikojnë/lexojnë në internet dhe mediat sociale që në moshë të re.

### *Ku paraqiten më shpesh stereotipet gjinore dhe sjelljet stereotipike gjinore?*



Për 38.8% të grave të reja dhe 36.2% të burrave të rinj, përkatësisht çdo të tretë të anketuar, shfaqen gjithashtu stereotipet gjinore dhe kultivohen në institucionet arsimore, përkatësisht në kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme dhe fakultetet. Për 10% më shumë, të anketuarat femra besojnë se stereotipet gjinore shfaqen dhe kultivohen në procesin e arsimit, domethënë, në mesin e nxënësve/nxëneseve, në tekstet shkollore dhe nga arsimtarët, mësuesit dhe profesorët, krahasuar me të anketuarit e rinj.

Kjo do të thotë se vajzat më shpesh i vërejnë stereotipet gjinore që ndikojnë në mënyrë disproporcionale në procesin arsimor, siç e përmendëm në hulumtimin e mësipërm.

---

*„Stereotipet gjinore janë më të përhapura në shkolla. Kujtoni orët e edukatës fizike. Meshkujt luajnë futboll dhe basketboll, ndërsa vajzat luajnë lojëra për femra... ose ndonjë gjë tjetër që i përshtatet femrave..“ (Mashkull i ri, 25-29 vjeç)*

---

Rrethi shoqëror, përkatësisht miqtë, janë në vendin e katërt si një hapësirë në të cilën shfaqen stereotipet, për 32.2% të të anketuarve dhe 36.3% të të anketuarave, që e konsiderojnë shoqërinë si një vend ku shfaqen stereotipet gjinore. Presioni i bashkëmoshatarëve mund të formësojë zgjedhjet e adoleshentëve përmes gatishmërisë për të zbuluar vetëm disa tipare të dëshirueshme për miqtë dhe në përputhje me zgjedhjet dhe sjelljet e të tjerëve. Kështu, në mënyrë që të pranohen nga mjedisi dhe miqtë, të rinjtë shpesh i nënshtrohen roleve gjinore të shkaktuara nga stereotipet dhe paragjykimet gjinore.

Vendi i punës u identifikua nga 27.6% e të anketuarve dhe 30.2% e të anketuarave si vendi ku shfaqen stereotipet gjinore. Mediat tradicionale si televizioni, radioja dhe mediat e shkruara citohen si burim i stereotipeve gjinore nga vetëm 20.5% e meshkujve të rinj dhe 24.9% e vajzave të reja. Ky vlerësim është për shkak të faktit se mediat tradicionale nuk janë një kanal informacioni që u shërben të rinjve, kështu që ekzistenca e stereotipeve gjinore në përmbajtje kalon pa u vënë re. 54.9% e të anketuarave dhe 58.5% e të anketuarve deklaruan se shikojnë televizion për më pak se një orë gjatë ditës. Kur bëhet fjalë për gazetat dhe radion, midis 83% dhe 85% e të anketuarve përdorin këto kanale tradicionale të mediave më pak se një orë në ditë ose nuk i përdorin fare.

Përmbajtja reklamuese e shfaqur në mediat tradicionale është e mbushur me stereotipe gjinore<sup>30</sup>, kështu që gratë janë më të përfaqësuara në reklama për mjete higjienike për kuzhinë dhe tualet; reklamimi i pajisjeve të kuzhinës, enëve të gatimit, erëzave; reklamimi i pajisjeve kozmetike dhe mjeteve që imponojnë standardet e bukuri, etj. Prania e meshkujve në reklama zakonisht bazohet në një paraqitje të fortë, dominuese të ashtuquajtur ‘mashkullore’ dhe me vetëbesim, në reklamimin e makinave, sport, parfume, por shpesh shoqërohet nga gra të objektivizuara seksualisht. Stereotipet gjinore paraqiten edhe në emisione argëtuese, lajme dhe fushata zgjedhore<sup>31</sup>.

---

30. A. Jovkovska, (2021) Stereotipet gjinore në funksion të kulturës konsumatore, Instituti për Letërsi Maqedonase

31. V. Reçica, A.J. Gjorgjeviq, J. Bliznakovski, (2020) Gjinia në Fushatën Zgjedhore 2020: Analizë e Çështjeve Gjinore dhe Mënyra e Shfaqjes dhe Përfaqësimit të Grave dhe Burrave në Përfaqësimin zgjedhor mediatic në televizionin kombëtar, në dispozicion online në <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2021/06/Finalna-analiza-na-rodovi-prasanja-v.6-1.pdf>




## A PRAKTIKOJNË TË RINJTË MENDIMIN GJINOR (JO)STEREOTIPIK?

59.3% e të rinjve të anketuar u përgjigjën se burrat dhe gratë nuk kanë trajtim të barabartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por a marrin pjesë ata vetë në krijimin ose kultivimin e trajtimit të pabarabartë? Edhe pse shumica e të rinjve besojnë se stereotipet gjinore janë të dëmshme dhe nuk i mbështesin ato, atyre iu bënë disa pyetje në fushat tematike për të përcaktuar nivelin në të cilin të rinjtë nuk besojnë me të vërtetë ose besojnë në stereotipet gjinore dhe prej ku burojnë pabarazitë gjinore në shoqëri.

### Sjellja, emocionet, aftësitë dhe pamja

Duke pasur parasysh një nga stereotipet themelore gjinore që ndjekin të rinjtë që para lindjes së tyre, bëmë një përpjekje për të përcaktuar nëse ky stereotip gjinor ruhet dhe të rinjtë besojnë në këtë bindje të përgjithësuar. 77.4% e të anketuarave dhe 68.8% e të anketuarve nuk pajtohen me këtë mendim. Megjithatë, një e pesta e të rinjve mendojnë se të gjithë djemtë pëlqejnë blu, dhe të gjitha vajzat ngjyrën rozë.


### Të gjithë djemtë u pëlqen bluja ndërsa të gjithë vajzave u pëlqen ngjyra rozë



Para paraqitjes së kukullës Barbie dhe princesshave të Disney që ndihmuan në krijimin e këtij stereotipi të rrënjosur thellë, ngjyra rozë konsiderohej një ngjyrë neutrale gjinore, ashtu si e bardha. Për më tepër, ngjyra rozë ishte një ngjyrë të cilën e përdorte gjerësisht borgjezia evropiane në shekullin e 18-të. Nuk ekzistonte diçka si ngjyrë që "përcaktonte" gjininë deri diku midis fundit të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të. Lidhja e ngjyrës rozë me gratë dhe feminitetin filloi rreth fillimit të shekullit të 20-të. Sipas Valerie Steele, drejtoreshë e Institutit të Modës në Muzeun e Teknologjisë në Nju Jork, "burrat në botën perëndimore filluan të vishnin gjithnjë e më shumë ngjyra të errëta", kështu që ngjyrat pastel dhe më të lehta u liheshin grave. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtria gjermane ndryshoi gjithçka, duke përfshirë konventat e ngjyrave dhe ngjyrat me bazë gjinore që do të diktonin identitetin gjinor në dizajn dhe modë. Ashtu si ushtria gjermane i detyroi hebrenjtë të mbanin një yll të verdhë për t'u identifikuar, i detyroi homoseksualët të mbanin trekëndësh ngjyrë rozë të përmbytur, që është pjesë e një sistemi kompleks identifikimi që përfshin kriminelët dhe të burgosurit politikë. Që nga ky moment në histori, bazuar në homofobi, ngjyra rozë konsiderohet ngjyrë "jo-gjermane" e rezervuar për vajzat.


Edhe pse të rinjtë në përqindje të madhe thonë se nuk praktikojnë stereotipe gjinore, megjithatë shumica ose 42.6% e të rinjve kanë një bindje të fortë se ka rroba për burra dhe gra që janë të përshtatshme për burra dhe gra biologjike dhe sipas kësaj norme gjinore duhet të vishen. 37.9% e grave pajtohen me këtë. Deri në fund të shekullit të 18-të, ishte e pranueshme që burrat të vishnin taka të larta, ndërsa u bë e pranueshme që gratë të vishnin pantallona në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Ashtu si të gjitha stereotipet gjinore, edhe ky është i ndryshueshëm.

### Vajzat duhet të vishen me tesha për ferma ndërsa djemtë me tesha për meshkuj




Që në moshë shumë të re, vajzave u jepen lodra për të mësuar se si të kujdesen për të tjerët, ndërsa djemve u jepen lodra të lëvizshme për të lëvizur nëpër hapësirën më të gjerë. Një në katër gra të reja dhe një në tre burra të rinj pajtohen me këtë stereotip. Me këtë mënyrë të rritjes së fëmijëve, në të cilën prindërit dhe mjedisi i ngushtë përcaktojnë se çfarë është e mirë për ta, ne u mësojmë fëmijëve një ndarje binare, e cila vazhdon të ndikojë në zgjedhjen e arsimit, punës, etj.

### Vajzat duhet të luajnë me kukulla ndërsa djemtë duhet të luajnë me makina dhe kamionë




Të presësh që vajzat të jenë të buta, të qeta dhe pasive shkakton dëme të barabarta për vajzat, ashtu si edhe presioni mbi djemtë që të jenë të fortë dhe të mos qajnë. Shumica, përkatësisht 75% e të anketuarave dhe 60.3% e të anketuarave, nuk besojnë se fëmijët duhet të udhëhiqen nga këto stereotipe gjinore. Pasiviteti i vajzave çon në situata ku ato heshtin për dhunën që u ndodh, ndërsa presioni për të qenë të forta kur standardi nuk mund të përmbushet mund të çojë në vetëvrasje. Sipas statistikave, gratë janë shumë më shpesh viktimat të dhunës me bazë gjinore, ndërsa burrat më shpesh kryejnë vetëvrasje.

### Vajzat duhet të jenë të buta ndërsa djemtë mund të jenë të fortë




Termi “emocional/e” në shoqëri zakonisht lidhet me gratë që qajnë dhe stereotipet gjinore. Kur bëhet fjalë për emocionet, ato janë të ndryshme: lumturia, trishtimi, zemërimi, hidhërimi, turpi, dashuria, xhelozia dhe të gjithë njerëzit gjatë gjithë jetës i ndjejnë dhe i shprehin ato në mënyra të ndryshme. Perceptimi i të anketuarve të rinj për këtë çështje është paksa i ndryshëm nga ato të mëparshmet. Një e katërta e të anketuarve besojnë se burrat janë më pak emocionalë se gratë, ndërsa 64.1% e të anketuarve nuk pajtohen. Emocionaliteti tek gratë shpesh shoqërohet me ndryshime të humorit gjatë ciklit menstrual, por përmeshja e zemërimit dhe hidhërimit tek burrat rrallë shoqërohet me supresimin e emocioneve të ndjenjave të tjera si trishtimi, turpi, etj.

### Burrat janë më pak emocionalë se gratë.




84.1% e të anketuarve dhe 81.60% e të anketuarve nuk besojnë se djemtë dhe burrat duhet të përdorin dhunën dhe agresionin për të provuar maskulinitetin e tyre. Gjithashtu, mbi 70% e të anketuarve dhe mbi 65% e të anketuarve nuk pajtohen se mospërdorimi i dhunës ose agresionit nga djemtë do të thotë se ata do t'i nënshtrohen dhunës së bashkëmoshatarëve.

### Djemtë dhe burrat pritet të përdorin dhunë dhe agresivitet sepse kështu dëshmohet maskuliniteti




## Një djalë që nuk përdor dhunë ose agresion mund të jetë subjekt i bulingut




Megjithëse kanë marrë pjesë në shpikjen e automjeteve të para, gratë u bënë shofere aktive në fillim të shekullit të 20-të. 81% e të anketuarave nuk i konsideronin gratë si shofere të këqija, as 69.6% e burrave. Ky stereotip gjinor, edhe pse të rinjtë mendojnë se është kapërcyer, ende dëgjohet shpesh në jetën e përditshme dhe në trafik.

## Gratë janë shoferë të këqij, ndërsa burrat shoferë të mirë



78.4% e vajzave të reja nuk mendojnë se duhet të jenë të bukura dhe të holla për të qenë tërheqëse për djemtë dhe burrat, ndërsa 2/3 e djemve pajtohen me to. Megjithatë, çdo djalë i pestë beson në këtë stereotip, ndërsa me këtë edhe në standardet e krijuara artificialisht të bukurosisë, të cilat, natyrisht, në kultura dhe periudha të ndryshme kohore janë të ndryshme dhe të ndryshueshme.


## Vajzat dhe gratë duhet të jenë të bukura dhe të holla për të qenë tërheqëse për djemtë dhe burrat.




Shumica e të anketuarave 67.2% dhe 57.4% e të anketuarve besojnë se bazuar në pamjen e tyre fizike, gratë nuk kanë trajtim të barabartë, ndërsa 52.8% e të anketuarave dhe 56.8% e të anketuarve konsiderojnë të njëjtën gjë për burrat.

Më shumë se gjysma e të anketuarve besojnë se pamja fizike, e imponuar nga stereotipet dhe rolet gjinore, ka një ndikim në mënyrën se si do të trajtohen gratë ose burrat.

*Të gjitha gratë trajtohen në mënyrë të barabartë pavarësisht nga pamja e tyre fizike në R.M.V*



*Të gjithë meshkujt trajtohen në mënyrë të barabartë pavarësisht nga pamja e tyre fizike në R.M.V.*



Stereotipet gjinore tek të rinjtë lidhen kryesisht me sjelljen e djemve dhe vajzave, pamjen e tyre, përkatësisht rrobat, si dhe karakteristikat që gratë dhe burrat duhet të kenë, pasivitetin kundrejt dominimit. Stereotipet gjinore janë thellësisht të brendshme dhe nuk mund të ndryshohen në një periudhë të shkurtër kohore. Gratë e reja janë më pak të ndjeshme ndaj stereotipeve gjinore sesa burrat e rinj. Është vërejtur se të rinjtë në veçanti i refuzojnë stereotipet gjinore që lidhen me pritshmëritë për veten e tyre, ndërsa ata më shpesh mbështesin pritshmëritë që synojnë gratë.

## Zgjedhja e arsimit

Ndarja gjinore në zgjedhjen e arsimit në Maqedoninë e Veriut ka qenë e dukshme gjatë viteve. Sipas të dhënave nga publikimi i fundit Gratë dhe Burrat në Maqedoninë<sup>32</sup> e Veriut të ESHS-së, në vitin shkollor 2021/2022, 70% e mësuesve në arsimin fillor dhe 62% e mësuesve në shkollat e mesme janë gra. Gjimnazi është më i preferuari midis nxënësve të shkollave të mesme në vitin 2020/2021, me 55% nxënës femra kundrejt 45% nxënësve meshkuj. Situata është e kundërt në arsimin e mesëm profesional, 55% nxënës meshkuj, në krahasim me 45% nxënës femra. Shumica e vajzave janë të regjistruara në mjekësi 76%, kozmetike 74% dhe shkollën e mesme të baletit 70%, ndërsa djemtë janë shumica në makineri 91%, elektro 86% dhe shkollat e mesme të edukimit fizik 85%.

Në vitin 2021, 91% e studenteve femra u diplomuan në fushën e arsimit, pasuar nga kujdesi shëndetësor dhe social me 76% të të diplomuara femra dhe 74% të të diplomuara femra në fushën e arteve dhe shkencave humane.

32. Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut (2023) ESHS, në dispozicion online në <https://www.stat.gov.mk/PrikaziPosledna-Publikacija.aspx?id=23>

Djemtë diplomohen më shpesh në fushat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, 67%, pasuar nga fusha e shërbimeve 60% dhe bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinari me 58% të diplomuar meshkuj. Megjithatë, edhe pse ekziston një stereotip gjinor që djemtë janë më të mirë në matematikë dhe vajzat në gjuhë, në fushën e shkencave natyrore, matematikës dhe statistikave në vitin 2021, diplomuan 71% femra<sup>33</sup>.

Siç u përmend, stereotipet shpesh kryqëzohen dhe mund të kombinohen në varësi të shpërndarjes së pushtetit në shtet. Në vitin shkollor 2018/2019, për shembull, 19% e vajzave romë dhe 18.4% e djemve romë nuk ishin regjistruar në arsimin fillor. Përqindja më e madhe e fëmijëve romë që nuk shkojnë në shkollë filllore janë adoleshentë (13-14 vjeç), në periudhën e pubertetit<sup>34</sup>.

Kjo do të thotë se ata ndërpresin procesin arsimor pak para se të hyjnë në kategorinë e të rinjve (15-19), megjithëse arsimi fillor dhe i mesëm është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Stereotipet në bazë të përkatësisë etnike, klasës dhe gjinisë çojnë në diskriminim dhe përjashtim të grupeve të caktuara nga shoqëria dhe pengojnë ushtrimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Një 64% e lartë e të anketuarve dhe 63.1% e të anketuarave nuk pajtohen me stereotipin gjinor që vajzat janë më të mira se djemtë në shkollë. Megjithatë, një e pesta e të anketuarave besojnë në këtë stereotip. Suksesi i nxënësve/nxënësve është individual dhe varet nga shumë faktorë të ndryshëm si: aftësia për të ndjekur shkollën, interesi për një lëndë/fushë të caktuar, aftësia për t'iu kushtuar mësimin, mbështetja e prindërve/kujdestarëve, mbështetja dhe qëndrimi pozitiv i mësuesve/mësueseve, koha e nevojshme për të zotëruar një fushë të caktuar, disponueshmëria e materialit mësimor të përshtatshëm për nevojat, etj.

Gjinia, domethënë faktori biologjik nuk është i lidhur ngushtë me suksesin e shkollës, por nëse shoqëria, prindërit, mësuesit presin më shumë nga vajzat dhe më pak nga djemtë në shkollë, fëmijët/të rinjtë do të japin aq sa u kërkohet ose pritët. Pra, ky është një tjetër stereotip gjinor i ndërtuar nga shoqëria.


Më shumë se gjysma (60%) e të anketuarave besojnë se djemtë/burrat dhe vajzat/gratë kanë qasje të barabartë në mundësitë arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, 28.4% e të anketuarave dhe 24% e të anketuarave nuk besojnë se djemtë dhe vajzat kanë qasje të barabartë në mundësi arsimore.

---

33. Ibid.


34. MICS 2018-2019

**A mendoni se djemtë/burrat dhe vajzat/gratë kanë qasje të barabartë në mundësitë arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?**




Përveç kësaj, të anketuarit gjithashtu dhanë një përgjigje në lidhje me përvojën e tyre personale, përkatësisht nëse në familjen e tyre vajzat u mbështetën dhe u inkurajuan për të përfunduar një shkollë më të lartë të arsimit, për të cilën 18% e të anketuarve/anketuarave u përgjigjën negativisht. Kjo do të thotë se gjithsej 106 të anketuara, përkatësisht 17.6% e numrit të përgjithshëm të të anketuarave nuk janë inkurajuar nga anëtarët e familjes së tyre për të vazhduar arsimin dhe për të përfunduar një shkollë më të lartë të arsimit.

**Në familjen tuaj, a inkurajohen vajzat të kryejnë arsim të lartë?**




Stereotipet gjinore janë ende të përhapura në familjet e të rinjve, kështu që presioni nga anëtarët e familjes për të zgjedhur një fushë të veçantë arsimore, ose kufizimi për të mos vazhduar me arsimin, kërcënon të ardhmen e të rinjve.

## Vajzat janë më të mira në shkollë se djemtë




